



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 164 prot.

Fierzë, më 22.01.2026

PROCESVERBAL

TEMA: KONSULTIM PUBLIK MBI PROJEKTVENDIMIN PËR DHËNIE NË PËRDORIM FONDI PYJOR PUBLIK, NË EKONOMINË PYJORE IBALLE-MËZI 2 (PJESA MËZI) PËR ENERGJI TË RINOVUESHME, (FOTOVOLTAIKE), TERRITORI ADMINISTRATIV I BASHKISË FUSHË-ARRËZ.

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 18 pika 1, pika 2, neni 54 germa (dh), germa (f) dhe në Rregulloren për Funksionimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz (VKB Nr. 15, datë 27.04.2020) Neni 153, Neni 154, **u mbajt sot, më 22.01.2026, në ambientet e Njesisë Administrative Fierzë, Ora:11:00, dëgjesa publike mbi projektvendimin "Për dhënie në përdorim Fondi Pyjor publik, në Ekonominë Pyjore Iballe-Mëzi 2 (Pjesa Mëzi) për Energji të Rinovueshme, (Fotovoltaike), territori administrativ i bashkisë Fushë-Arrëz".**

Në takim morën pjesë:

1. **Ylber Sokoli**, Administrator i Njesisë Administrative Fierzë.
2. **Ded Lleshi**, Specialist Kadastrë & GIS në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve e Kullotave.
3. **Sokol Vata**, Specialist në Drejtorinë e Administrimit të Pyjeve e Kullotave.
4. **Naze Selimaj**, Sekretar për Këshillin Bashkiak.
5. **Silvio Pashkaj**, Specialist i emergjencave civile në bashki.

Të pranishëm nga publiku në këtë dëgjese publike janë **banorët e Njesisë Administrative Fierzë, të fshatrave Kokdodë, Mëzi, Fierzë, Arst, Miliska, Porav, Bugjon, Aprripe si dhe kryetarë të fshatrave.**



Naze Selimaj, Sekretare e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, falënderon për pjesëmarrjen në këtë dëgjesë publike, e cila organizohet në kuadër të transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrjen vendore. Gjithashtu Znj. Selimaj bën prezantimin e ekipit të bashkisë dhe të temës së diskutimit të dëgjesës publike mbi projektvendimin “Për dhënie në përdorim Fondi Pyjor publik, në Ekonominë Pyjore Iballe-Mëzi 2 (Pjesa Mëzi) për Energji të Rinovueshme, (Fotovoltaike), territori administrativ i bashkisë Fushë-Arrëz”.



Fjalën hapëse e mbajti Administratori i Njesisë Administrative Z. Ylber Sokoli:



Ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen dhe ju uroj mirëseardhjen ekipit që do të shpalosë projektin lidhur me dhënien në përdorim Fondi Pyjor publik, në Ekonominë Pyjore Iballe-Mëzi 2 (Pjesa Mëzi) për Energji të Rinovueshme, (Fotovoltaike).

Administratori i Njesisë Administrative Z. Ylber Sokoli e konsideron dëgjesën shumë të rëndësishme për informimin dhe njohjen e banorëve me çdo planifikim përmes projekteve në kuadër të zhvillimit të zonave të Njesisë Administrative Fierzë.

Z. Sokoli u shpreh se nuk do të ndalojmë në zhvillimin e zonës përmes projekteve gjithmonë në bashkëpunim dhe dakordësi me banorët e zonës së Njesisë Administrative Fierzë dhe kjo falë mbështetjes e bashkëpunimit me Bashkinë Fushë-Arrëz dhe Kryetarin Z. Hil Curri.

Ded Lleshi, Specialist Kadastre & GIS në Sektorin e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave :

Të nderuar banorë, përfaqësues të komunitetit, sot jemi këtu për t’ju prezantuar projektvendimin që



ka të bëjë me Dhënie në përdorim të Fondit Pyjor Publik, në Ekonominë Pyjore Iballe-Mëzi 2 (Pjesa Mëzi), për qëllime të prodhimit të energjisë së rinovueshme, fotovoltaike, në territorin administrativ të bashkisë Fushë-Arrëz.

Projektvendimi synon të lejojë përdorimin e një sipërfaqeje të caktuar të fondit pyjor publik, konkretisht në zonën Iballe-Mëzi 2, pjesa Mëzi, për ndërtimin e një impianti fotovoltai, pra për prodhimin e energjisë elektrike nga dielli.

Është e rëndësishme të theksojmë se nuk bëhet fjalë për tjetërsim apo shitje të pronës publike por për dhënie në përdorim, sipas legjislacionit në fuqi, me kushte të përcaktuara qartë për mbrojtjen e mjedisit dhe interesit publik.

Energjia fotovoltaike është energji e pastër për mjedisin, ndihmon në uljen e ndotjes dhe mbrojtjen e natyrës, kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të zonës dhe të vendit në tërësi, krijon mundësi për investime dhe zhvillim ekonomik lokal.

Ky projekt është në përputhje me politikat kombëtare për energjinë e rinovueshme dhe mbrojtjen e mjedisit. Në çdo fazë të zbatimit do të respektohen standardet mjedisore, do të merren masa për minimizimin e ndikimit në fondin pyjor, bashkia dhe institucionet përkatëse do të ushtrjnë kontroll dhe monitorim të vazhdueshëm.

Gjithashtu, mendimi dhe shqetësimet tuaja janë të rëndësishme dhe do të merren në konsideratë përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Qëllimi i kësaj dëgjese publike është t'ju informojmë në mënyrë të drejtpërdrejtë, të dëgjojmë pyetjet, mendimet dhe sugjerimet tuaja dhe të sigurojmë që çdo vendimmarrje të jetë sa më transparente dhe në interes të komunitetit.

Sokol Vata, Specialist pyjore:

Përshëndetje të gjithëve! Ju falenderojmë që jeni sot këtu për të biseduar rreth këtij projekti i cili është i rëndësishëm edhe si projekt por mbi të gjitha duhet të shfrytëzohet në të mirë dhe në dobinë tuaj si banorë dhe aq më tepër për banorët e Meziut. Duhet të kuptoni se çdo projekt duhet të jetë në radhë të parë në shërbimin tuaj.



Bardhok Nika, banor i Njesisë Fierzë, uron mirëseardhjen të gjithëve dhe falenderon Administratorin e Njesisë Fierzë për organizimin e takimit.

Ylber Sokoli, Administrator i Njesisë Administrative Fierzë, pyet Bardhok Nikën nëse është dakord me projektin.

Bardhok Nika, banor i Njesisë Fierzë: tani mbas shpjegimit të projektit jam dakord 500% vetëm që zona të zhvillohet.

Gjovalin Kola, banor i Njesisë Fierzë: Ne si banorë të zonës kemi nevoja të shumta në Mezi për rrugë dhe investime. Sa për projektin s'kemi pse e zgjasim, shpyr që investohet.

Palush Gjoni, Kryetar i fshatit Fierzë:



Falenderoj
Administratorin e Njesisë
Administrative Z.Ylber
Sokoli për për
bashkërendimin e
organizimit lidhur me
këtë dëgjese publike.
Resurset që kemi duhet të
shfrytëzohen.

Jemi dakord të investohet
në zonën tonë por pa prek
pronat tona.

Agim Marashi, banor i fshatit Mezi, shprehet se është dakord me projektin që prek fshatin e tij. Ky projekt do të sjellë dhe përmirësimin e rrugëve dhe zhvillimin e zonës.

Vat Prela, në tokat tona as stanin nuk ia shesim askujt. Ne si banorë, jemi dakord me çdo projekt që si rezultat ka zhvillimin e zonës dhe mirëqenien e banorëve.

Ded Lleshi, Specialist Kadastre & GIS në Sektorin e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave falenderon të pranishmit për pjesëmarrjen dhe mendimet e sugjerimet e tyre.





Bashkëlidhur këtij procesverballi, gjendet lista e pjesëmarrësve në këtë dëgjese publike.

SEKRETAR PËR KËSHILLIN BASHKIAK

Naze SELIMAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK



LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTËN PUBLIKE MBI PROJEKTVENDIMIN,
"PËR DHËNIE NË PËRDORIM FONDI PYJOR PUBLIK NË EKONOMINË PYJORE
IBALLE -MËZI 2 (PJESA MËZI), PËR ENERGJI TË RINOVUESHME (FOTOVOTAIKE),
NJËSIA ADMINISTRATIVE FIERZË, BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	Gentian	Vdoci			
2.	Opelosh	Sto e			
3.	Agim	Marashi			
4.	Mhill	Zela			
5.	Olak	Hajdori			
6.	Jafmir	UKA			
7.	Gjergj	SOXOH			
8.	Fatmir	Kyreni			
9.	Palush	Gjoni			
10.	Qik	Gerji			
11.	Ad	Gjoni			
12.	Skender	Nika			
13.	Fred	Muri			
14.	ROS	Abaz			
15.	Bordhe	Ull			



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE NË KONSULTËN PUBLIKE MBI PROJEKTVENDIMIN,
"PËR DHËNIE NË PËRDORIM FONDI PYJOR PUBLIK NË EKONOMINË PYJORE
IBALLE -MËZI 2 (PJESA MËZI), PËR ENERGJI TË RINOVUESHME (FOTOVOTAIKE),
NJËSIA ADMINISTRATIVE FIERZË, BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr.	Emër	Mbiemër	Njësia/Qyteti/Fshati	Pozicioni/Profesioni	Firma
1.	ELTON	MAJZI			
2.	DORJAN	BERIMI			
3.	ELTON	MATOSHI			
4.	Relman	Matoshi			
5.	LIRIM	PREKA			
6.	SOKOL	IBRAH			
7.	Yllzer	Sokol			
8.	Naze	Selimonaj	F-Arrëz	Sekretare e KB	
9.					
10.					
11.					
12.					
13.					
14.					
15.					